



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

### VENDIM

Nr.119, Datë 22.07.2019

#### MBI

### FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2 gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 5, pika 1 gërma “d”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr.09, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr.96 datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 22.07.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

#### Konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike që prej datës 21.12.2009, dhënë me vendim të bordit të ERE-s, nr.102 dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s me nr.84, datë 16.09.2014.
- Shoqëria “GSA” sh.p.k., ka aplikuar në ERE për rinovimin licencës në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 437 Prot., datë 05.07.2019.
- Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
  - **Formati i aplikimit** (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- **Çdo modifikim ose ndyshim te mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike** (neni 16, pika 1, gërmat “d”) është plotësuar në mënyrë korrekt;

Në kuadër të plotësimit të kësaj kërkesë të rregullores shoqëria ka paraqitur në ERE sasitë e parashikuara për të furnizuar si më poshtë:

- 294 GWh në vitin 2019;
- 294 GWh në vitin 2020;
- 294 GWh në vitin 2021;
- 350 GWh në vitin 2022;
- 350 GWh në vitin 2023.

Ka paraqitur Listën e Kontratave të mëparshme të realizuara:

Shoqëria “GSA” sh.p.k., ka paraqitur në formë listë tabelare kontratat e furnizimit që ka aktualisht me disa prej kompanive prezente në Tregun Shqiptar të Energjisë elektrike si: Kid – Alb, 2AT sh.p.k, Fresh sh.p.k, Confort sh.p.k, ALFA sh.p.k në nivelin e tensionit 35kV. Gjithashtu kjo shoqëri numëron eksperiencë ndër vite edhe me shoqëri të tjera si ALBCHROME sh.p.k, FUSHË KRUJE CEMENT FACTORY sh.p.k, KURUM INTERNATIONAL sh.a, COLACEM ALBANIA sh.p.k, ARMO sh.a dhe ENERGJI ASHTA sh.p.k dhe shprehet se mbetet në dispozicion për çdo qartësim apo plotësim të nevojshëm.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës, të shoqërisë shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**PETRIT AHMETI**